



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	02.12.2024
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – nëntor 2024

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2024, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.11.2024-30.11.2024

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit nëntor 2024-janë pranuar gjithsejtë 49 kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë 16 lëndë, që në total rezultojnë të jenë 65-lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 41 kërkesa, 31 të miratuara, 8 të refuzuara dhe 2 të ceduara.

Për shqyrtim barten 24 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Nga data 7.11.2024 ka filluar zbatimi i programit për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

- Është zhvilluar Takim konsultativ me autoritetet nga MMPHI përkatësisht udhëheqësin e Komisionit për shqyrtimin e Raportit të VSM-së për PZHK, për sfidat në finalizimin e procesit të VSM, perkatesisht mungesën e përgjigjes zyrtare nga MMPHI.
- Është zhvilluar takim konsultativ në Komunën e Fushë Kosovës lidhur me procesin e hartimit të PZHK-së për Komunen e Fushë Kosovës, në kuadër të konsultimeve publike dhe ndikimet në këtë proces që nderlidhen me zhvillimet dhe planifikimin e projekteve në kuadër të bashkëpunimit nderkomunal.
- Pjesëmarrja në Takim informues mbi Programin e Banimit Social Adekuat në Kosovë, i organizuar nga MMPHI dhe mbështetur nga Asistenca Teknike e WBIF përmes IPF11.
- Pjesëmarrja në Takim e organizuar nga ZLK, lidhur me trajtimin e çështjes së banimit të një rasti në Janjevë.
- Pjesëmarrja në Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve.
- Janë plotësuar Pyetësoret e lejeve të ndërtimit TM1-TM2-TM3 për vitin 2024, sipas kërkesës së ASK-së.
- Është realizuar Takimi konsultativ me grupin punues në kuadër të Programit për lehtësimin e procedurave administrative në shërbimet komunale.
- Zhvillimi i procedurës për përgatitje dhe plotësimin/ harmonizimin në kuadër të Raportit vjetor të punës – të treguesve nga Performanca Komunale për vitin 2025.
- Pjesëmarrja në punëtorinë e realizuar nga Zyra për barzi gjinore në Lipjan në bashkëpunim me Organizatën CLARD dhe KADE me temën “Te drejtat pronësore, procesi i regjistrimit të pronës dhe shërbimet kadastrale”.
- Pjesëmarrja në takim në MMPHI, Komisioni i paleve të interesit “Sistemi fotovoltail 17.00MWp” Z.K. Rufe i Ri dhe Dobrajë e Madhe, Komuna e Lipjanit,
- Pjesëmarrja në Punëtori “Trajtimi i vendbanimeve joformale”.
- Pjesëmarrja në takim konsultativ në MMPHI për temën “banimi social”.

Edhe gjatë këtij muaji kemi vazhduar me aktivitetet në kuadër të Komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale me qëllim të realizimit të projekteve sipas Vendimeve të Kuvendit të Komunës të miratuara me datën 29.03.2024.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

Çështja e emërimit të rrugëve duke pasur parasysh regjistrimin zyrtar të adresave.

Hartimi i Planit vjetor të punës së DPUMM – 2025.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Të pezulluar	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	11	3	7		3		4
2.	Leje ndërtimi	5	3			1		7
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve të përkohshme	3	-	3				
4.	Leje rrënimi	1		1				
5.	Certifikatë përdorimi	1	1	1				1
6.	Kërkesa për pëlqime parimore							
7.	Akte nga MMPHI me efekte juridike	1					1	
8.	Nr. i shtëpisë /adresa							
9.	Informacione urbane	10	1	9				1
10.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	5	3	2		2		4
11.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
12.	Njoftim për palen/ftesa							
13.	Tërheqje e lëndës dhe vendimi për pushimin e procedurës							
14.	Ndërrim destinimi (tokës)							
15.	Ankesa	1					1	
16.	Kërkesë për mbrojtje mjedisore							
17.	Kërkesa për pezullim të procedurës							
18.	Vendosje e paneleve solare në ndërtesa							
19.	Kërkesa të tjera	5	2	6		1		
20.	Kerkese per LMK	5	3	1		1		6
21.	Njoftime	1		1				
	Gjithsejtë:	49	16	31		8	2	24

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit nëntor 2024 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

SFIDAT:

Lidhur me sfidat kemi raportuar në muajt paraprak të vitit 2024

Shënim:

Numrin e kërkesave të shqyrtuara të të gjitha natyrave për nga përmbajtja, kemi arritur ta sjellim në nivel të arsyeshëm të shyrimit brenda afateve kohore.

BUXHETI:

Gjatë muajit raportues kemi vazhduar me realizimin e të hyrave nga trajtimi i kërkesave për leje ndërtimore dhe kategoritë tjera. Gjatë këtij muaji janë realizuar të hyra si në vijim:

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:..... 0.00€
- Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:0.00€
- Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....5,949.61€
- Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....1,607.95€
- Te hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej75.50€

Shuma totale e të hyrave:7,633.06€

Shpenzimet:

Në procesin e shpenzimeve kemi vështirësi të theksuara për shkak të pamundësisë së planifikimit të saktë të kryerjes së hartimit të projekteve dhe sidomos lidhur me finalizimin e Raportit të VSM-së dhe shpenzimeve për PZHK. Procesi i PZHK-së aktualisht është pezulluar për shkak të rrethanave me të cilat i kemi njoftuar edhe anëtarët e Kuvendit Komunal.

Po ashtu Thesari nuk ka marr parasysh kërkesat për lirim të mjeteve të pa shpenzuara edhe pse të njëjtat janë parashtruar me kohë dhe sipas procedurës përkatëse.